



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2020:028885

Datë: 30.04.2021

Numri i dokumentit: 01751871

C.nr. 100/20

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË — DEGA NË GLLOGOC**, Departamenti i Përgjithshëm — Divizioni Civil, si gjykatë civile e shkallës së parë me gjyqtarin Daut Qela dhe sekretaren juridike Teuta Berisha, në çështjen juridike të paditësit **M. Z. E. nga fsh. B.-Komuna e Gllogocit, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit S. Z., avokat në G., kundër të paditurës Komuna e Gllogocit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gllogoc të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore**, me objekt të kontestit kompensim i shujtës ditore, për ditët e pranisë në punë, vlera e kontestit 762 €, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 22.04.2021, në praninë e të autorizuarit të paditëses, e pa praninë e të autorizuarit të të paditurës, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**-I-. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M. Z. E. nga fsh. B.-Komuna e G..

**DETYROHET** e paditura Komuna e Gllogocit- Drejtoria Komunale e Arsimit në Gllogoc që paditësit t'i paguaj, në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë si punë primare në arsim me nga 2 € në ditë dhe atë:

-Për vitin 2017 nga dt. 18.04.2017 për 45 ditë punë, t'i paguaj shumën prej 90 €;

-Për vitin shkollor 2017/18 për 185 ditë pune t'i paguaj shumën prej 370 €;

-Për vitin shkollor 2018/19 për 151 ditë pune t'i paguaj shumën prej 302 €, apo shumën e përgjithshme për shujta prej 762,00 € për gjithsejtë 381 ditë pune, me kamatë ligjore prej 8%, e deri në pagesën përfundimtare e të gjitha këto t'i përmbush në afat prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kanosjen e përmbarimit ligjor.

**-II-. DETYROHET** e paditura Komuna e Gllogocit- Drejtoria Komunale e Arsimit në Gllogoc, që ti paguaj paditësit shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 425,00 € dhe atë 104 € për padi, 165€ për precizimin –rregullimin e padisë, 135 € për një seancë gjyqësore, si dhe 21 € për taksë gjyqësore, në afatin prej 7 dite pas marrjes së aktgjykimit nën kanosjen e përmbarimit ligjor.

**A r s y e t i m**

Paditësi në padinë e parashtruar në gjykatë me dt. 25.02.2020 dhe gjatë shqyrtimit kryesor, si dhe precizimit –rregullimit të padisë të dorëzuar me dt. 15.03.2021 përmes të autorizuarit të tij, ndaj të paditurës Komuna e Glllogocit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Glllogoc, ka parashtruar padi për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, për ditët e pranisë në punë, në mbështetje të nenit 53.7 ë Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, e aprovuar me dt. 18.04.2017 nga ana e subjekteve kompetente të MASHT dhe SBASHK-ut , por e paditura me një njoftim formal e pa aktvendim meritore me ka njoftuar se e ka refuzuar kërkesën time me arsyetimin se kjo çështje duhet rregulluar në nivelin qendrorë, nga ana e subjekteve që e kanë nënshkruar këtë kontratë, deri sa për këtë qëllim nuk janë alokuar mjetet financiare.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e dt. 15.03.2021 ka bërë rregullimin dhe precizimin e padisë duke theksuar se; pasi që shuma për kompensim në petitumin e padisë nuk është precizuar, bëjë precizimin duke kërkuar që për 381 ditë të pranisë në punë, duke filluar nga dt. 18.04.2017 e deri me dt. 13.05.2019 kërkojmë kompensimin në shumën prej 762, 00 € me kamat ligjore prej 8 % nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në ditën e përmbarrimit me kanosje për ekzekutim me dhunë.

Në seancën kryesore i autorizuari i paditësit ka deklaruar se: paditësi M. E., punëtorë mësimdhënës në SHFMU „Migjeni” në Baicë, me dt. 25.02.2020 ka parashtruar kërkesëpadi në këtë gjykatë për kompensim të shpenzimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë nga dt. 18.04.2017, prej kur ka hyrë në fuqi kontrata kolektive e Arsimit në Kosovë, e deri më dt.13.05.2019 kur është pensionuar paditësi dhe atë për çdo ditë të pranisë në punë nga 2 €, që do të thotë se për 381 ditë të punës kërkojnë të kompensohet në shumën prej gjithsejtë 762,00 €, dhe atë me kamat ligjore në shkallen prej 8 % nga dita e paraqitjes së kërkesës padisë e deri në marrjen e formës së prerë të aktgjykimit në kanosje për përmbarrim me dhunë.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, kërkesëpadi i ka bashkangjitur këto prova-dokumente kontratën e punës të vërtetuar dhe nënshkruar nga personi përgjegjës, kalendarin e ditëve të mësimin për vitet 2016/2021 , vërtetimin mbi ditët e pranisë në punë, të dhëna nga Institucioni ku është duke punuar paditësi, kontratën e punës të vërtetuar dhe nënshkruar nga personi përgjegjës ku paditësi ka punuar, dëshminë mbi taksën gjyqësore nga paditësi si dhe autorizimin e dhënë përfaqësuesit të tij. Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigjen e dhënë në padi e ka kundërshtuar padinë nga shumë aspekte për të njëjtat kundërshtime janë të pa argumentuara sipas të autorizuarit të paditësit .

Në rastin konkret nuk kemi veprim retroaktiv me rastin e paraqitjes së kërkesës për kompensim të shpenzimeve të ushqimit nga se me vetë nxjerrjen e kontratës Kolektive paditësi nuk është fajtorë për mos angazhimin të organeve të theksuara në përgjigje në padi për sigurimin e mjeteve të nevojshme për realizimin e pagesës sipas kontratës kolektive, askund në kontratë nuk theksohet se paditësi duhet të jetë anëtare i SBASHK nga se ai përfaqësohet nga Sindikata e Arsimit në Kosovë, nuk ka nevojë që kontrata e punës e paditësit të parashihet kompensimin e theksuar nga se kjo çështje është e paraparë me aktin nënligjorë –kontratën e punës.

Mbi të theksuarat e më sipërme vlerësojmë se kërkesëpadia e ka të vërtetuar bazën juridike mbështetur në nenin 35 . 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e ku në mënyrë decisive thekson se: citojmë të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për një ditë pune kompensimi është 2 €, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës apo në ndonjë formë tjetër nuk ka obligim një kompensim të tillë.

Në rastin konkret paditësi ka bazë ligjore reale për të kërkuar një kompensim të tillë sipas kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e cila kontratë është nxjerrë nga organi komentet qendrorë.

I konsiderojmë të pa provuara faktet e theksuara nga përfaqësuesi i të paditurës të dhëna në përgjigje në padi lidhur me këtë çështje nga se organet qendrore si në kontratën kolektive të arsimit vetë e kanë nënshkruar një kontratë e cila është në fuqi por tani nuk duan të e zbatojnë me arsyetim se ende nuk janë krijuar kushtet për zbatim të saj apo se nuk janë alokuar mjete financiare për këtë qëllim rast si ky i pa precedent.

Theksimet e përfaqësuesit të paditurës se nuk ka kushte për zbatim të një kontrate të tillë janë jo reale e po aq edhe të pa arsyetuara ku një organ nuk donë të zbatoj një dispozitë të cilën vetë e ka nxjerr të aprovuar si në rastin konkret.

Nuk qëndron fakti se nuk janë shterur mjetet juridike nga ana e paditësit nga se paditësi i është drejtuar me kërkesë të paditurës për kompensimin e tillë, por e paditura nuk i ka dhënë përgjigje në afatin e paraparë ligjore gjegjësisht nuk e ka njoftuar paditësin mbi refuzimin e padisë por çështjen e ka lënë në heshtje administrative.

Paditësi në afatin ligjorë me kërkesë që i është drejtuar inspektoratit të punës e pa përgjigje ka ushtruar padi në gjykatën kompetente si do që të jetë çështja e kompensimit se a është paraparë me dispozitën e ligjit të Punës të Kosovës kjo çështje është e rregulluar me dispozitën e kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë sipas nenit 78 të Ligjit të Punës e paditura është dashur që paditësit ti kthej përgjigje në afatin prej 15 ditësh, pra sipas nenit 78. 3 te të njëjtit ligj e paditura është dashur të merr aktvendim duke njoftuar paditësin brenda afatit të paraparë, por e paditura e ka anashkaluar këtë obligim ligjorë sipas nenit 79 te të njëjtit ligj, i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se janë shkelur të drejtat nga mardhënja e punës gjegjësisht se nuk ka marrë fare përgjigje në afat nga neni 78 .2 të Ligjit të punës në afatin vijues prej 30 ditësh mund të inicioj kontest pune në Gjykatën kompetente ashtu siç ka vepruar.

E paditura me dt. 30.03.2021 ka ushtruar përgjigje në padi përmes së cilës e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se: për shkak të mos shterjes së mjeteve të brendshme juridike brenda të paditurës, i propozojmë Gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë me aktvendim ta hudhë si të pa lejuar, E paditura e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

I autorizuari i të paditurës nga Avokatura Shtetërore nuk ka qenë në seancën gjyqësore për tu deklaruar por përmes postës elektronike me parashtrësë pas seancës me dt. 20.04.2021 ju ka drejtuar Gjykatës duke u deklaruar për seancë dhe duke theksuar se: mbetet në tërësi pran përgjigjes në padi duke e kundërshtuar në tersi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa lejuar, dhe e paditura e kundërshton në tërësi padinë e paditësit si të pa bazuar.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, sipas propozimit të të autorizuarit të paditësit ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova si: Vërtetimi i paditësit për praninë në punë i lëshuar nga SHFMU „Migjeni“ në Glllogoc me nr. prot. 2478/18 e dt. 02.08.2018, Kërkesa e paditësit drejtuar DKA-së, në Glllogoc, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë nr. 09-070/20-9509 i dt. 20.02.2020, Njoftimi nga DKA në Glllogoc, lidhur me kërkesën e paditësit drejtuar të paditurës me nr. 09-070/01-9509 e dt. 21.02.2020, Parashtrësë për precizimin dhe rregullimin e padisë me C.nr.100/20 e dt. 15.03.2021, Aktvendimi për pensionim të paditësit M.E. me nr. 09-610-27296 i dt. 20.05.2019, Vërtetim i lëshuar nga Komuna e Glllogocit, SHFMU „Migjeni“ në Baicë nr. prot. 547/20 i dt. 11.01.2021, Kontratë për punë për mësimdhënie me nr. 714 i dt. 12.11.2015, Kalendarët për vitet shkollore 2016/2017, 2017/2018, 2018/19, 2019/2020, 2020/21, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, me nr. C.nr. 100/20 i dt. 18.03.2021 ku detyrohet e paditura për përgjigje në padi, Përgjigja në padi nga e paditura e dt. 30.03.2021 me nr. C.nr. 100/20, Dhe parashtrësja me deklaratë për seancën e sotme C.nr. 100/20 e dt. 20.04.2021.

Nga kërkesa me numër 09-070/01-9509 e datës 20.02.2020, vërtetohet fakti se paditësi ka kërkuar nga e paditura kompensimin e shujtës-ushqimit nga data 18.04.2017, kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e deri në përmbushjen e tyre në tërësi.

Nga kontrata e punës që paditësi tani posedon me numër 714 e datës 12.11.2015 vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune si mësimdhënës tek e paditura, përkatësisht në SHFMU “ Migjeni” në Baicë, ndërsa orë punë në javë i ka gjithsejtë 40 orë, ku sipas kontratës paditësi ka qenë në marrëdhënie pune deri me dt. 13.05.2019 kur edhe është pensionuar.

Nga vërtetimi i përvojës së punës me nr. prot. 2478/18 të dt. 02.08.2018, vërtetohet se paditësi ka përvojë pune 43 vite e 11 muaj.

Nga vendimi e dt. 01.07.2019 vërtetohet fakti se paditësi M. E. është pensionuar me dt. 13.05.2019.

Nga vërtetimi me nr.prot. 547/20 i datës 11.01.2021, vërtetohet se paditësi gjatë periudhës prej 18.04.2017 e deri me dt. 13.05.2019 si mësimdhënësi ka pasur gjithësejtë ditë pune 381 deri në ditën kur është pensionuar.

Gjykata për aprovimin e kërkesëpadisë për shujta si në pikën I të dispozitivit është bazuar në dispozitat e nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 në të cilën shprehimisht është përcaktuar “*Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranishme në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënie të punës primare në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të*

*punësuarve përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër nuk ka obligim për të bërë kompensimin*". Në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese në mes të palëve se e paditura nuk iu ofron ushqim të punësuarve në asnjë formë siç përcaktohet me Kontratën Kolektive të Arsimit. Gjykata me rastin e vendosjes së çështjes konkrete juridike është bazuar edhe në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku është përcaktuar "*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në marrëveshje të tillë kolektive*". Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar si rezultat i provave të administruara pa mëdyshje u vërtetua se kërkesëpadia e paditësit lidhur me shujtat është e bazuar.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet e palës së paditur ku ka theksuar se paditësi nuk i ka shterrur mjetet juridike brenda institucionit ku ka punuar duke mos ushtruar kërkesë për realizimin e të drejtave të shkelura, Gjykata i mori parasysh, por këto pretendime nuk i aprovoi duke i konsideruar si të pa bazuara sepse paditësi me datë 20.02.2020, ka parashtruar kërkesë tek e paditura për realizimin e kompensimit për shujta si në padi ku e njëjta i ka kthyer përgjigje, ndërsa me nenin 3 të Udhëzimit Administrativ nr.17/2015 të datës 06.11.2015 për orët e punës së personelit në Institucionet që zbatojnë programet për arsim dhe aftësim profesional është përcaktuar se "Orët e punës së personelit mësimor në IAAP, janë 40 orë në Javë të cilat përfshijnë: punët profesionale të drejtpërdrejta në procesin edukativo-arsimor dhe punë të tjera të cilat burojnë drejtpërdrejtë nga procesi edukativo-arsimor dhe aftësimi".

Lidhur me ditët e punës gjykata është bazuar në kalendarët e viteve shkollorë 2016 deri më 2020/21 të lëshuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë gjatë të cilës periudhë paditësi nuk ka munguar në punë, fakt ky i vërtetuar me vërtetimin nr.prot. 547/20 të datës 11.01.2021.

Po ashtu gjykata ka pasur parasysh edhe pretendimet tjera të paditurës ku ka theksuar se në bazë të nenit 46 par.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë MASHT dhe SBASHK-u angazhohen bashkërisht në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunitet e Republikës së Kosovës me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare por këto pretendime nuk i aprovoi sepse paditësit një e drejtë e tillë i është garantuar me nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017.

Gjykata konsideron se padia e paditësit është e afatshme, ndërsa fakti se paditësi ka punuar tek e paditura gjykata e ka vërtetuar me vërtetimin nr. 547/20 të datës 11.01.2021 me të cilin vërtetohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune nga viti shkollorë 2016/2017 e gjerë më 13.05.2019 ku dhe është pensionuar.

Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e kërkuar për periudhën e lartcekur është në përputhje me vërtetimin nr. 547/20 të datës 11.04.2021 të cilës gjykata ia fali besimin e plotë pasi që i njëjti është lëshuar nga vet e paditura.

Gjykata ka vendosur që e paditura t'i paguaj paditësit kamatën prej 8 % në vit nga dita e marrjes së aktgjykimit duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së.

Vendimin me të cilin e paditura është detyruar që paditësit ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 425 €uro dhe atë për përpilimin e padisë në shumën prej 104 €, për rregullimin-precizimin e padisë shumën prej 165 €, për taksën gjyqësore për padi shumën prej 21 € dhe për përfaqësim për një seancë gjyqësore shumën prej 135 €, është bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Nga e larte theksuara u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË GLLOGOC**  
**DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM — DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.100/20 i dt.22.04.2021**

Sekretare Juridike  
Teuta Berisha

Gj y q t a r i  
Daut Qela

**KËSHILA JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate, në dy kopje.